

CURRICULUM VITAE

EMRI: ARIAN
MBIEMRI: PAÇO
DATELINDJA: 23 Tetor 1957
VENDLINDJA: TIRANE

ARSIMI:
1972- 1976 Shkolla e Mesme Artistike “Jordan Misja”
1977- 1981 Akademia e Arteve (sot Universiteti i Arteve)

PROVIME PASUNIVERSITARE:

- Analizë Forme
- Historia e Muzikës Shqiptare
- Filozofi
- Gjuhë Angleze
- Gjuhë Italiane

KURSE PERFEKSIONIMI, MASTER CLASS-e

- 1991-1992 Scuola di Musica di Fiesole. (Itali)
- Korrik 1991 Orlando Festival (Hollandë)
- Korrik 1992 Academie Musicale de Villecroze. (Francë)
- Gusht 1992 Accademia Musicale Chigiana (Itali)
- Shtator 1992 Recontres Musicales de Villarceaux (Francë)

AKTIVITETI

Pas diplomimit me vlerësim maksimal në Akademinë e Arteve (sot Universiteti i Arteve) në klasën e Prof. Gjergj Pekmezit në vitin 1981, ka punuar si violist në Orkestrën e Teatrit të Operas dhe Baletit (TOB) duke marrë pjesë aktive në të gjitha aktivitetet artistike të këtij institucioni brenda apo jashtë vëndit deri në vitin 1988.

Në vitin 1983 angazhohet në mësimdhënie si pedagog i jashtëm në Liceun Artistik “Jordan Misja” dhe në vitin 1985 si pedagog i jashtëm i klasës të violës në Akademinë e Arteve. Në vitin 1988 emërohet pedagog në Akademinë e Arteve si titullar i klasës së Violës dhe Muzikës së Dhomës.



Në vitin 1999 merr titullin “*Profesor i Asociuar*”, dhe në vitin 2013 titullin “*Profesor*”. Gjatë viteve 2000 - 2008, ka kryer detyrën e *Përgjegjësit të Seksionit të Muzikës së Dhomës*, ndërsa në periudhën 2015 – Maj 2016, detyrën e *Zv.dekanit në Fakultetin e Muzikës*. Gjithashtu ka kryer edhe detyrën e *Kryetarit të Këshillit të Profesorëve të Fakultetit të Muzikës*.

Në klasën tij janë diplomuar mbi 50 studentë të cilët aktualisht punojnë në institucionet qëndrore artistike dhe arsimore të vendit (Orkestren e TOB, TVSH, shkollat artistike, Universitetin e Arteve etj.) si dhe në Evropë e Amerikë. Ka botuar artikuj në shtypin e shkruar dhe në vitin 2005, nga shtëpia botuese ”ARTES”, i është botuar libri metodik për instrumentin e violës i titulluar “*Viola*”.

Ka kryer një seri master-classes me artistë prestigjiozë si *Earl Carlyss, Valentin Erben, Piero Farulli* dhe *kuartetin “Esaye”* dhe ka ndjekur disa kurse perfeksionimi duke u diplomuar në Fiesole dhe në “*Akademinë Chigiana*” në Itali.

Si një ndër instrumentistët më aktivë në jetën artistike, ka zhvilluar një aktivitet të gjërë artistik si ansamblist, solist dhe orkestrant. Ka luajtur si solist me orkestrën e TOB, e Universitetit të Arteve, e RTVSH, Heinrich Heine Symphoniker (Gjermani) me MPO (Malaysian Philharmonic Orchestra), me filarmoninë e Prishtinës, me filarmoninë e Shkupit, si dhe në koncerte të ndryshme recitale brënda dhe jashtë vendit. Ka koncertuar me instrumentistë të shquar botëror si *Pavel Vernikov, Till Engel, Cristian Lardie* etj. Në vitin 2008 është nominuar nga Akademia “*Kult*” si instrumentisti më i mirë i vitit.

Është një nga themeluesit e kuartetit “*TIRANA*” me të cilin ka koncertuar në shumë vënde të Evropës si Angli, Francë, Austri, Gjermani, Zvicër, Suedi, Itali, Libi, Kroaci, Rumani, Maqedoni, Kosovë etj, duke marrë pjesë në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare si “*Orlando Festival*”(Hollandë), *Festivali i Ohrit*, (Maqedoni), *Festivali i Dubrovnikut* (Kroaci), “*Festival Toscana delle Culture*”(Itali), *Remusica, Kosova Kamerfest* etj. Suksesin më të madh me këtë kuartet e ka arritur në vitin 1991 duke fituar “**Çmimin Special te Jurisë**” në konkursin ndërkombëtar të kuarteteve të harqeve në Evian, Francë.

Ndër bashkëpunimet dhe regjistrimet mund të përmendim ato me *RTV Shqiptar, S.D.R.*(Gjermani), *Swedish Radio* (Suedi), *Suisse Romande Espace 2* (Zvicër) etj.

Gjithashtu ka regjistruar dy CD me shtëpitë diskografike *Pentaphon* dhe *Amiata Records* (Itali)